



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 255/5 prot.

Tepelenë, më 02.02.2026.

V E N D I M

Nr. 6, datë 29. 01. 2026

PËR ZHVILLIMIN E PRONËS NË FSHATIN DRAGOT ME NUMËR PASURIE 392 ZONA KADASTRALE NR. 1529, ME PËRFITUES BASHKINË TEPELENË DHE ZHVILLUES CESVI ALBANIA (OJF) SI DHE AUTORIZIMIN E ZHVILLUESIT APO PËRFAQËSUESIT, TË APLIKOJË PËR PAJISJEN E OBJEKTIT/INVESTIMIT ME LEJET PËRKATËSE, NË PORTALIN “E-ALBANIA”

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)”; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar; Relacionit nr. 171 prot, datë 23.01.2026 të Grupit të punës pranë Bashkisë Tepelenë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

V E N D O S I:

1. Zhvillimin e pronës në fshatin Dragot me numër pasurie 392, zonën kadastrale nr. 1529, me përfitues Bashkinë Tepelenë, dhe zhvillues CESVI Albania (OJF) si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit me prokurë noteriale, të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin “e-Abania”.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015
“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të
Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me	12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro	12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur më datë 02.02.2026	

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

